



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.NR. 301/10

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga Rafet Haxhaj, kryesues, Nehat Idrizi dhe Vlastimir Dimic, anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Zumreta Kasumoviq kandidate për deputete në Parlamentin e Kosovës, nga radhët e Subjektit Politik Bosnjscka Stranka Demokratske Akcije Kosova (BSDAK) nga Vitimirica-Pejë, që ka të bëjë me tërheqjen nga lista e kandidateve, në seancën e mbajtur me datë 02.12.2010 mori këtë:

VENDIM

HIDHET poshtë apeli si i pasafatshem

ARSYETIM

Zumreta Kasumoviq kandidate për deputete në Parlamentin e Kosovës, nga radhët e Subjektit Politik Bosnjscka Stranka Demokratske Akcije Kosova (BSDAK) nga Vitimirica-Pejë, ka parashtruar apel për tërheqjen nga lista e kandidatëve për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Parashtruesja e apelit ka deklaruar se është njoftuar nga disa miq të saj se gjendet në listën e kandidatëve të subjektit politik BSDAK dhe se për këtë arsye deklaroi nën përgjegjësinë e plotë morale, materiale dhe penale se nuk ka qenë në dijeni në lidhje me ndonjë aktivitet politik që ka të bëjë me zgjedhjet e 12.12.2010. Ajo shton se nuk ka pasur kurrfarë bisedimesh me asnjë nga subjektet politike dhe as me BSDAK-në.

Parashtruesja e apelit kërkon që PZAP-i të bëjë fshirjen e emrit të saj nga lista e kandidatëve të subjektit politik BSDAK sepse ka të bëjë me rastin i cili është falsifikuar dhe se iu është regjistruar emri i saj pa pëlqimin e saj.

FAKTET

PZAP ka pranuar një apel më datë 30.11.2010 nga Zumreta Kasumović kandidatë për deputetë në Parlamentin e Kosovës, nga radhët e Subjektit Politik Bosnjëska Stranka Demokratske Akcije Kosova (BSDAK) nga Vitimirica-Pejë, e cila kërkon tërheqjen nga lista e kandidatëve nga ky subjekt politik.

Parashtruesja e apelit ka pohuar që kandidimi i saj është bërë pa pëlqimin e saj.

ANALIZË

Juridiksioni i PZAP-it lidhur me ankesat është caktuar në pajtim me autorizimin e dhënë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës në Ligjin Nr. 03/L-256, dhe Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës (Ligji Nr. 03/L-072).

Tërheqja e një kandidati nga listat e kandidatëve nga një subjekt politik ose nga vet kandidati është e rregulluar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme (Nr. 03/L-073),

Neni 122 pika c) LZP përcakton:

Personi fizik ose juridik, të drejtat ligjore të cilat janë prekur nga cilat do vendime të më poshtme, vendime këto të marra nga KQZ-ja, mund të apeloj atë vendim në PZAP brenda 24 orëve pasi që vendimi i apeluar shpallet nga KQZ-ja dhe apeli duhet vendoset nga PZAP-i brenda shtatëdhjetedy (72) orëve pasi të jetë parashtruar apeli.

c) kandidatin i cili pas certifikimit nuk dëshiron të marrë pjesë në zgjedhje;

Lista e kandidatëve konsiderohet të jetë e certifikuar nga KQZ-ja në kohën e tërheqjes së shortit më 20 nëntor 2010, në ora 17:00 ndërsa afati për parashtrim të ankesës në PZAP, në këtë fazë të procedurës ka qenë njëzetekatër (24) orë pas certifikimit gjë që nuk e ka bërë Kandidatja Zumreta Kasumović nga BSDAK-ja.

Sipas dispozitës së lartëcur PZAP-i konstaton se ankesa është e pasafatshme, sepse apeli në PZAP është pranuar më datë 30.11.2010, ndërsa afati për parashtrim të ankesës në PZAP, në këtë fazë të procedurës ka qenë njëzetekatër (24) orë.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë

A nr. 301/2010 më datën 02.12.2010.

Kryesuesi i Panelit

Rafet Haxhaj



Handwritten signature and the number '2'.